



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.409/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Astrit Ahmeti, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Dragashit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Dragash, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në numërimin e votave dhe mos arritjen e fletëvotimeve të diasporës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 07.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.409/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Astrit Ahmeti, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Dragashit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Dragash, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në numërimin e votave dhe mos arritjen e fletëvotimeve të diasporës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 05.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.409/2025, e parashtruar nga Astrit Ahmeti, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Dragashit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Dragash, në të cilën thekson se nga dokumentacioni dhe procesverbalet e mbledhura nga përfaqësuesit e mi, konsideroj se një numër i konsiderueshëm votash të vlefshme për mua janë shpallur gabimisht të pavlefshme ose nuk janë përfshirë fare në rezultatet përfundimtare, në vendvotimet Kuk, Bellobrad, Zaplluxhe dhe Pllav, Kjo është një shkelje e të drejtave të kandidatëve për zgjedhje komunale që përcaktohen në Ligjin për Zgjedhjet Komunale, në ndërlidhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili kërkon që çdo votë e vlefshme të numërohet dhe të përfshihet në rezultatin përfundimtar. Po ashtu në ankese theksohet se një shqetësim veçanërisht serioz paraqet mosarritja e fletëvotimeve për votuesit e regjistruar në diasporë, duke privuar qytetarët e regjistruar nga e drejta e tyre për të votuar. Dëshmitë konkrete përfshijnë rastet e familjeve Ramadani, Ahmeti dhe Berisha ku disa fletëvotime nuk kanë arritur kurrë ose kanë

arritur vetëm për pjesën e vogël të familjes, ndërsa pjesa tjetër është privuar nga e drejta kushtetuese e votës. Prandaj, konsideroj se PZAP është e detyruar të shqyrtojë këto ankesa brenda afateve ligjore dhe të marrë vendime urgjente Për rishqyrtim, rinumëron dhe korrigjim të rezultateve, nëse konstatohet se ka gabime që ndikojnë në rezultatin zgjedhor. Lista e votuesve të diasporës që nuk kanë marrë fletëvotimet përkatëse përfshin: Çlirim Ramadani, Itali, Afërdita Temaj Itali, Mukazire Ramadani Itali, Ylli Ahmeti, Gjermani Jasmine Rifaj, Liechtenstein, Selman Tahiri, Sloveni, Dren Tahiri, Slloveni, Sokol Tahiri Slloveni, Bardhok Tahiri, Slloveni, Agan Berisha, Itali, Beslinda Tahiri, Itali, Ardijana Berisha, Itali, Esmije Berisha, Itali, Nuri Berisha, Itali, Erolind Bojaxhiu, Fadil Zeneli, Majlinda Tahiri, Slloveni, Djellore Priaj, Sloveni, Liatif Eterni, Zvicër. Po ashtu parashtuesi i ankesës, thekson se gjitha këto raste janë të verifikueshme përmes sistemit postar ndërkombëtar dhe dokumentacionit të mbledhur, dhe duke marrë parasysh gravitetin e shkeljeve dhe ndikimin direkt në rezultatin zgjedhor, kërkoj që PZAP të rishqyrtoj dhe rinumëroj votat në të gjitha vendvotimet ku ka mospërputhje të evidentuar, të kërkoj nga KQZ korrigjimin e rezultateve dhe të sigurojë shpërndarjen e fletëvotimeve të diasporës sipas ligjit.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime, Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa persona kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e palës ankuese, ju njoftojmë se zarfet janë dërguar përmes Postës në adresat që janë deklaruar nga vetë votuesit gjatë procesit të regjistrimit. Sa i përket mospranimit të zarfeve nga votuesit, nga Posta KQZ është njoftuar se ekzistojnë dy arsye kryesore pse një zarf kthehet mbrapa, Adresa e deklaruar nga votuesi nuk është e saktë apo është e paplotë (mungon numri i banesës apo i rrugës); në këtë rast, zarfi kthehet në KQZ, Votuesi nuk ka qenë në shtëpi për ta pranuar dërgesën. Në këto raste, Posta vendos njoftimin në adresën e votuesit për ta marrë dërgesën

në zyrën postare. Nëse brenda afatit të përcaktuar nga Posta marrësi nuk paraqitet për ta tërhequr dërgesën, atëherë zarfi kthehet në KQZ. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet e palës ankuese për persona të tjerë, lidhur me mos dërgimin e zarfeve të personat e përmendur në ankesë, duhet të ceket se ata persona në rast të shkeljes së të drejtave të tyre lidhur me procesin zgjedhor, është dashur të parashtrojnë vetë ankesë në PZAP. Pritjet e palës ankuese për të marrë më shumë vota nga votimi jashtë Kosovës nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe Llogaritja matematikore nuk argumenton shkeljet e pretenduara.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit Astrit Ahmeti, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Dragashit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Dragash, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave sa i përket votave të derguara me postë nga diaspora. Sipas vlerësimit të panelit vetëm pretendimi nga ankesa se “dokumentacioni dhe procesverbalet e mbledhura nga përfaqësuesit e mi, konsideroj se një numër i konsiderueshëm votash të vlefshme për mua janë shpallur gabimisht të pavlefshme ose nuk janë përfshirë fare në rezultatet përfundimtare, në vendvotimet Kuk, Bellobrad, Zaplluxhe dhe Pllav,” sipas vlerësimit të panelit këto pretendime janë të pabazuara për faktin se parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij me prova konkrete, edhe vet ankuesi nuk është i sigurtë në pretendimet e tij të cilat paraqiten më shumë si hamendësime të tij se sa pretendime reale, andaj rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, Paneli në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e të familjarëve të ngushtë, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është përcaktuar se “1.3. *liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.*” Prandaj për këtë arsye nuk i mori si të bazuara, përkatësisht, nuk ia fali besimin deklarinimit se familjarët e ngushtë kanë votuar për të njëjtin, për të aprovuar ankesën si të bazuar.

Duhet cekur se lidhur me deklarata e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: “*deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kane votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund*

të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”.

Po ashtu lidhur me pretendimet e palës ankuese për persona të tjerë, lidhur me mos dërgimin e zarfeve të personat e përmendur në ankesë, Paneli vlerëson se të njëjtin persona në rast të shkeljes së të drejtave të tyre lidhur me procesin zgjedhor, është dashur të parashtrinë vetë ankesë në PZAP brenda afateve të parapara ligjore, e nuk legjitimohet këtu kandidati për parashtrimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Astrit Ahmeti, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Dragashit, nga subjekti politik PDK, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse që dëshmojnë parregullsi gjatë numërimit të votave me postë dhe mungesës së votave tek kandidati. Andaj pretendimet e ankuesit mbetet vetëm në suaza të dyshimit se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetohen pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZLAnr.409/2025 datë 07.11.2025

Kryesues i panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.